

**STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“STILOSAMENTE” SH.P.K.**

Ky statut përpilohet nga:

- Paola Sula**, e bija e Dashnor Sula, lindur më 12/06/1995, banuese në Rrugë Irfan Tershana 12, Tiranë 1001 Shqipëri, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me pasaportën nr. BG7002240 dhe nr. Personal J55612082N
- Matteo Casanova**, i biri i Mauro Casanova, lindur më 12/12/1989 banues në Via Privata 9, Massagno 6900 Zvicër, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me kartë identiteti nr. AV7354451
- Giuseppe Marino** i biri i Vito Marino lindur më 23/12/1993, banues në Via Filadelfia 126, Torino TO 10137 Itali, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pajisur me pasaportën nr. YB4517450

Të quajtur më poshtë ortakët themelues, të cilët në përputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, vendosën të përpilojnë këtë statut si vijon:

**KREU I
NENI 1
THEMELIMI**

Ortakët e mësipërm krijuan këtë Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin N.9901/14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**NENI 2
EMRI I SHOQERISE**

Emri i shoqërisë do të jetë “**STILOSAMENTE SH.P.K.**”.

**NENI 3
SELIA E SHOQERISE**

Selia e shoqërisë do të jetë në qytetin e Tiranës me adresë Rrugë George W. Bush, Kulla 2, Nr.24 Tirana, Shqipëri. Me vendim të asamblesë së ortakëve mund të hapë



degë ose zyra përfaqësie në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë ose jashtë vendit.

NENI 4 KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë e papërcaktuar.

NENI 5 OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj:

Prodhimin dhe tregtimin me shumicë, pakicë dhe online, importimin dhe eksportimin, edhe me anë të platformave dhe software-ve online, si dhe ushtrimin e aktivitetit në pika shitje të artikujve të festave dhe të dhuratave, bizhuteri, kanceleri, syze, parfume, lodra e pajisje elektronike të përgjithshme; tekstile dhe artikuj për arredimin e shtëpisë dhe kopshtin, produkte elektronike dhe elektrike, artikuj materiale ndërtimi, të orave, veshje përmeshkuj, femra dhe fëmijë, veshje të brendshme, aksesorë përveshje, artikuj lëkure, canta, valixhe, këpucë dhe aksesorë lëkure dhe në përgjithësi të atyre artikujve që nuk bëjnë pjesë në sektorin ushqimor, si dhe organizimin e eventeve dhe konsulenca dixhitale. Ajo mund të kryejë, edhe pse jo në lidhje me objektin e shoqërisë, të gjitha veprimet me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare, industriale e financiare, këto të fundit jo ndaj publikut, por të dobishme përrarrjen e objektit të shoqërisë; së fundmi mund të kryejë financime të përgjithshme dhe të lëshojë garanci edhe reale, ndaj të tretëve, me qëllim që këto veprime të mos kryhen ndaj publikut as në mënyrë dominuese.

KREU II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET dhe TRANSFERIMI

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë, i ndare në 3 kuota me vlerë sipas kontributit të secilit ortak. Asamblea e ortakëve ka të drejtë të rrisë kapitalin e shoqërisë. Rritja e kapitalit mund të bëhet edhe me anë të dhënies së kredive apo të mirave në natyrë. Shoqëria mund të përsitojë nga ortakët derdhjet në kapital pa detyrim rimbursimi, pra të nënshkruajë me ortakët financime me detyrim rimbursimi, me interes dhe pa interes.

NENI 7 KONTRIBUTET E KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë sipas nenit 6 të këtij statuti zotërohet nga:

33,33% Matteo Casanova

33,33% Giuseppe Marino

33,34% Paola Sula

NENI 8 SHPËRNDARJA E FITIMIT

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë i takon ortakeve themelues sipas kuotave të kapitalit që disponojnë.

NENI 9

TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT THEMELTAR

Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të transferohen me anë aktesh mes të gjallëve dhe me trashëgimi e cila do të ndahet në mënyrë të barabartë vendosur paraprakisht, e gjithë kuota objekt shitje ose një pjesë të saj. Njoftimi paraprak duhet të bëhet me anë të letrës rekomanduese, me njoftim përmarrjen dhe pasi ka kaluar afati prej tridhjetë ditësh nga dita e marrjes, në rast se ortakët nuk e kanë parashkruar të drejtën në favor të një personi, ortaku që shet do të jetë i lirë të transferojë kuotën e tij palës së tretë blerëse. Në rastet e më shumë ortakëve që duan të blejnë të njëjtën kuotë, ajo do të ndahet mes ortakëve në masë të njëjtë me kuotat që disponojnë në kapitalin e shoqërisë.

Në rast vdekje të një ortaku, ortakët e tjera ose mund të vazhdojnë marrëdhëniet me trashëgimtarët ose të likuidojnë kuotën e ortakut të vdekur.

Në rastin e parë trashëgimtarët mund të emërojnë njërin prej tyre ti përfaqësojë në shoqëri, në rastin e dytë trashëgimtarët do të likuidohen sipas situatës së pronësisë të përditësuar nga data e vdekjes, brenda dhe jo më shumë se një vit nga ajo ditë, pa interes.

Lirim i detyrimi duhet të kryhet me njoftim prej të paktën gjashtë muajsh. Likujdimi i kuotës së ortakut duhet të bëhet brenda dhe jo më shumë se një vit nga data e limit nga detyrimi referuar situatës së përditësur në atë datë.

KREU III MARRJA E VENDIMEVE, STRUKTURA JURIDIKE, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I SHOQERISE

NENI 10 ASAMBLEJA E ORTAKEVE



Asambleja e ortakëve organizon, drejton dhe kontrollon gjithë aktivitetin e shoqërisë. Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së kontributeve të tyre.

Ortakët vendosin mbi cështjet që kanë në kompetencia sipas ligjit nga ky statut, si edhe mbi cështjet e një ose më shumë prej administratorëve ose ortakëve që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit shoqëror ndaj aprovimit të tyre. Kanë të drejtën e votës ortakët e regjistruar në librin e shoqërisë dhe prezantë në dokumentat që posedon Gjykata përkatëse.

Në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji ose nga ky statut, ose kur e kërkon një osë më shumë prej Administratorëve ose ortakët që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit shoqëror, vendimet e ortakëve transmetohen me anë të procesverbalit të asamblesë. Asamblea duhet të mblidhet nga organi administrativ edhe jashtë selisë qëndrore, në Republikën e Shqipërisë ose territorin e një shteti tjeter të përzgjedhur mes Republikës Italiane apo Konfederatës Zvicerane. Në rast pamundësie të të gjithë Administratorëve, asamblea mund të thirret nga Organi Kontrollues, nëse ka, ose edhe nga një ortak. Asamblea mblidhet me anë të një njoftimi dërguar tetë ditë më parë ose nëse është dërguar më pas, të jetë marrë të paktën pesë ditë para datës së përcaktuar për mbledhjen, me letër rakomanduese ose postës elektronike, me cdo mjet tjetër të përshtatshëm që siguron marrjen e njoftimit, në vendin pranë Gjykatës ku rezulton e regjistruar shoqëria. Në cdo rast janë të vlefshme asambletetë të pa thirrura si më sipër, kur në to marrin pjesë të gjithë administratorët, me kapital të plotë, dhe janë prezantë ose të informuar mbi mbledhjen dhe askush nuk kundërshton trajtimin e cështjeve.

Asamblea kryesohet nga Administratori i Vetëm ose Presidenti i Këshillit Administrativ. Në rast emërimi të dy Administratorëve asamblea do të kryesohet nga ai më i vjetri në moshë. Në rast mungese Asamblea cakton mes të pranishmëve Presidentin. Asamblea emëron një Sekretar që mund të zgjidhet edhe mes jo ortakëve. Asamblea zhvillohet sipas normave në fuqi. Vendimet shënohen në procesverbal të firmosur nga Presidenti ose Sekretari ose Noteri. Asamblea e ortakëve mund të zhvillohet edhe në më shumë vende, me audio dhe/ose me video të lidhura, me të njëjtat kushte parashikuar nga statuti. Në njoftimin për mbledhje duhet të tregohen vendet që do të kenë audio dhe ose video të lidhura, në të cilat ata që do të marrin pjesë mund të ndërhynë dhe mbledhja quhet e kryer në vendin ku do të jetë prezent Presidenti dhe Sekretari. Në vendet ku ka audio dhe/ose video ku mbahet mbledhja duhet të jetë fleta e prezencave. Asamblea është rregullisht e përbërë nga prania e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 66,66% të kapitalit të shoqërisë dhe vendos mazhoranca absolute dhe me votën miratuese të ortakëve që përfaqësojnë të paktën 66,66% të kapitalit të shoqërisë. Në rastë të tjera kur

kërkohet mazhoranca specifike, do të respektohen dispozita të tjera të ligjit ose të këtij statuti.

**NENI 11
DREJTIMI I SHOQERISE**

Organ i lartë drejtues i shoqërisë do të jetë asambleja e ortakëve që mblidhet 2 (dy) herë në vit si dhe cdo herë që gjykohet e arsyeshme.

**NENI 12
KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE**

Asambleja e ortakëve vndos për keto çështje:

Emeron administratorin e shoqerise.

Emeron ekspertet kontabel.

Miraton bilancin vjetor.

Vndos per shperndarjen e dividentit te shoqerise.

Ben ndryshime ne statut.

Vndos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.

Ne rast te shperndarjes se shoqerise caktion likuidatorin dhe e shkarkon ate kur perfundon likuidimi.

Per cdo ceshtje tjetër

**NENI 13
ADMINISTRATORI**

Shoqeria do të administrohet nga një Administrator i Vetëm, emëruar sic përshkruhet më sipër, në detyrë për një vit, me të gjitha kompetencat e administrimit dhe përfaqësimit të Shoqërisë.

Fitimi që i takon administratorit përcaktohet nga akti i emërimit të tyre në lidhje me të drejtat që i takojnë ose me vendim. Administratori i shoqerise do te jete Znj. Gloria Bejte e bija e Fatmir Bejte e datelindjes 03.04.1993 , lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane , e paisur me Pashaporten Nr.BE5492991 dhe me numer personal J35403099A.

**NENI 14
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

Administratori i shoqërisë emërohet nga asambleja e ortakëve dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve të asamblesë së ortakëve. Afati i emërimit në detyrë i administratorit do të jetë 1 vit.

Administratori ka këto kompetenca në cdo rast me autorizim të asamblesë së ortakëve :

Të bëjë drejtimin e shoqërisë .

Te perpiloje dhe nenshkrueje kontratat dhe aktet juridike qe kane te bejne me veprimtarine e perditshme te shoqerise.

Te hapi llogari rrjedhese bankare

Te perfaqesoje shoqerine ne mardhenie me te tretet.

Te emeroje konsulentë për veprime të caktuara me kohë të përcaktuar

Te beje gjithçka tjeter qe konsideron te dobishme dhe qe eshte ne perputhje me statutin e shoqërisë për të arritur qëllimin dhe objektin e shoqërisë.

KREU IV

LIBRAT E LLOGARISE, VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE,

SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI

NENI 15

LIBRI SOCIAL

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje perveç dokumentacionit kontabel qe kerkon legjislacioni ne fuqi edhe keto libra :

- 1- Libri i ortakeve, ne te cilin shenohen emrat e plote te Ortakeve dhe kuotat qe secili ka ne kapitalin e themelimit.
- 2- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te asamblese.
- 3- Libri i mbledhjeve dhe i vendimeve te Administratorit

NENI 16

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTI KONTABEL

Cdo vit finanziar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti. Perjashtimi i viti i pare finanziar do te filloje pas regjistrimit te shoqerise si person juridik dhe do te perfundoje me 31 Dhjetor 2020. Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e veçanta te hartuara nga administratori miratohen nga asambleja e ortakeve. Miratimi i bilancit vjetor behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se viti finanziar.

NENI 17

AKTIVITETI FINANCIAR

Ne çdo mbyllje të çdo viti finanziar bëhet inventari dhe bilanci vjetor ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin. Për këtë hartohet një raport me shkrim bashkë me:

- Nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria,
- Nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria,

Raporti i administratoreve perfshi gjendjen gjate vitit finanziar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e mundshme qe jane zhvilluar nga data e mbylljes se vitit finanziar deri ne diten qe eshte hartuar ky raport.

Dokumentet vihen ne dispozicion te eksperteve kontabel te autorizuar, te pakten nje muaj para mbledhjes se asamblese.

NENI 18 FITIMI I SHOQERISE

Fitime neto te shoqerise do te konsiderohen fitimet qe rezultojne pas zbritjes nga te ardhurat e te gjitha shpenzimeve qe kane lidhje me aktivitetin e shoqerise, detyrimet fiskale, sigurimet shoqerore, demet, amortizimet, etj ne perputhje me legjislacionin në fuqi.

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi.

Perberja, shuma e per gjithshme, burimet per krijimin e fondit rezerve, perdonimi dhe rregullimi i çdo foni te veçante caktohet nga asamblea e ortakeve ne perputhje me legjislacionin në fuqi.

Ne perputhje me nenin 213 të ligjit "Mbi shoqëritë tregtare" nga fitimi i rezervuar gjate vitit finanziar lihet menjane nje shume me vlore 8% e cila destinohet per krijimin e nje foni "rezerve te domosdoshme".

NENI 19 PRISHJA E SHOQERISE

Shoqeria prishet në përputhje me ligjin. Shoqeria prishet perpara asatit me vendim te Asamblese së ortakeve.

NENI 20

Rastet e pavlefshmerise se shoqerise ose te nje akti qe ndryshon statutin si dhe bashkimi dhe ndarja e shoqerise bhet ne perputhje me dispozitat e ligjit mbi "Shoqëritë tregtare".

7/8

NENI 21

Kur shoqeria prishet ajo kalon ne likujdim dhe ne kete rast emertimit te shoqerise i shtohet shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper". Shoqeria edhe gjate procesit te likujdimit vazhdon si person juridik deri ne perfundimin e procesit te likujdimit.

NENI 22

Per te perfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e ortakeve emeron nje ose disa persona si likuidues te cilet perfaqesojne shoqerine. Likuiduesi perpilon reportin e likuidimit, bilancin finanziar, likujdon tek te tretet detyrimet e shoqerise, shet aktivet e shoqerise duke transferuar tepricat tek ortakët sipas rastit.

NENI 23

Ne perfundim te mbylljes se likuidimit, asamblea e ortakëve vendos per bilancin finanziar perfundimtar, per administrimin e tij nga ana e likuiduesit. Ajo revokon mandatin e likuiduesit, si dhe regjistron mbylljen e likuidimit. Dokumentat e mesiperme miratohen nga Asambleja e ortakeve .

NENI 24

Kur shoqeria likujdohet pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, u kthehen pronareve.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise dhe fondet fillestare ndahen ndermjet ortakeve pasi te jene likujduar kreditoret.

KAPITULLI V DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 25

Shoqeria ka te drejte te punesoje punonjes qe i nevojiten per te ushtruar veprimtarine e saj. Kontratat e punës behen sipas ligjit.

Te gjitha problemet qe do te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise te kesaj shoqerie do te zgjidhen sipas rregullave te percaktuara ne statutin dhe legjislacionin ne fuqi. Kur mosmarreveshjet nuk zgjidhen ne mirekuptim mes palëve, per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e shkalles se pare Tirane.

NENI 26

Ky statut firmoset me vullnetin e lire te ortakeve themelues.

THEMELUESIT

Tirane 04.06.2020

Giuseppe Ciliberto
G.C.

Paola Sula
PS.

Matteo Enverga
ME

8/8